



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH
Kryesia

Nr. 321 prot.

Gramsh, më 28/01 /2025

VENDIM

Nr. _____, datë ____ .01.2025

PËR

MIRATIMIN I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 17,56, 57 dhe “Rregulloren për Organizmin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Gramsh”, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e dates 27.01.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës për muajin Dhjetor të Këshillit të Bashkisë Gramsh, e cila do të mbahet në datën 30.01.2025 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Gramsh, Deputetët e qarkut dhe personat apo /dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Xhulia GJINI



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Enis ZANI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 321/1 prot.

Gramsh, më 28/01 /2025

Njoftim për Thirrjen e Mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Të nderuar Këshilltarë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për funksionimin e Këshillit”, njoftoj se mbledhja e muajit JANAR do të zhvillohet ditën Enjte datë 30/01/2025 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit me rend dite si mëposhtë:

- 1- Për miratimin e shumë së bashkëfinancimit të subvencionimit të qerasë.
(Sek. Emergjencave Civile dhe Strehimit)
 - 2- Për miratimin e kërkesave për subvencionim të qerasë për disa familje në nevojë bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.
(Sek. Emergjencave Civile dhe Strehimit)
 - 3- Për miratimin e shumës së bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara
*(Sek. Emergjencave Civile dhe Strehimit)
 - 4- Për miratimin e kërkesave për përfitimin e granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese për disa familje në nevojë, bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh.
(Sek. Emergjencave Civile dhe Strehimit)
 - 5- Për miratimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Gramsh.
(Kryetari)
 - 6- Për miratimin e kontratës së “ Shërbimit publik për pranimin,depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve te bashkisë Gramsh” në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”, midis bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë ‘ECO-ELB’sh.a.
(Kryetari)
 - 7- Relacion mbi mundësinë e përdorimit të fondit pyjor dhe kullosor , si dhe miratimin në parim të dhënies në përdorim /heqjes të fondit pyjor dhe kullosor publik në pronësi të Bashkisë Gramsh.
(Kryetari)
 - 8- Për administrimin e kullotave dhe livadheve si dhe dhënien e tyre me qera fermerëve fizike e juridike me anë të kontratave qiramarëse.
(Sek. i administrim -menaxhimit në pyje dhe kullota)
 - 9- Për miratimin e Të Ardhurave të Trashëguara për vitin 2024.
(Dr. Financave)
 - 10- Për miratimin e bashkëpunimit të Bashkisë Gramsh me Federatën Shqipëtare të Futbollit të projektit me objekt “Rikonstruksionin e Stadiumit “Myslym Koci” e ngritur me bashkëfinancim 50/50 të kësaj infrastrukture në qytetin e Gramshit.
(Dr. Urbanistikës)
 - 11- Kërkesa të qytetarëve & Të tjera.
- Duke ju falenderuar!**

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

Adresa: Sheshi “Kombos-Demashit” Detyrëdi “10 Kamilit” Tel. Fax: 0513 2 2273 E-mail: bashkia@gramsh@gmail.com